



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA GRAMSH
NJËSIA E PROKURIMIT**

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - PUNË

Datë 22/ 11 /2023

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMINE SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

**OBJEKTI I PROKURIMIT: “SISTEMIM ASFALTIM I LAGJES “XHILE LIÇI” BASHKIA
GRAMSH ”**

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): Punime rrugore
45233140-2**

VLERA E FONDIT LIMIT: 7 500 000 (shtatë milion e pesëqind mijë) lekë pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Gramsh, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8,*
- b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Argumentimi:

Argumentimi: Kërkesa për Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit bazohet në Ligjin Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 82 si dhe në VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni II, Neni 26.

Kërkesa e mësipërme për sigurimin e ofertës mbështetet në Ligjin Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 83, pika 1 si dhe në VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni II, Neni 30, pika 1.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:

Plotësimi i kapaciteteve ligjore nga operatorët ekonomikë dhe vërtetimi se ata kanë zotësi juridike për të lidhur kontrata prokurimi, bëhet me anë të paraqitjes prej tyre të deklaratës mbi përmbushjen e kriterëve të përgjithshme, sipas shtojcës 8.

Argumentimi:

Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenin 39, pika 6/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

Operatori ekonomik duhet të ketë burime financiare të nevojshme për realizimin e objektit të prokurimit dhe merr përsipër çdo rrezik që mund të ndodhë, siç parashikohet apo nënkuptohet në kushtet e përgjithshme dhe të veçanta të kontratës. Në këtë kontekst, operatorët ekonomikë duhet të tregojnë se i përmbushin kushtet e mëposhtme:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore 3 (tri) viteve të fundit financiare lëshuar nga administrata tatimore, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë sa 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, në shumën 3 000 000 (tre milion) lekë.(40% e fondit limit që prokurohet.)

Argumentimi:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43 pika 2 dhe pika 3 dhe nenin 55, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Vendosja e këtij kriteri kualifikues i shërbejnë Autoritetit Kontraktor, për të provuar nëse Ofertuesit zotërojnë kapacitet financiar për të përmbushur me sukses kontratën objekt prokurimi.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar se ky kriter kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zotëron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën.

2.2.2 Kopje të çertifikuara të bilanceve të 3 (tre) viteve të fundit (**2020, 2021, 2022**), të paraqitura në Administratën Tatimore dhe të konfirmuara prej tyre. Nëse operatori ekonomik ofertues është në kushtet e parashikuara nga neni 41, pika "c", e ligjit nr.10091 datë 5.3.2009 "Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabel të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar" i ndryshuar, atëherë secili bilanc duhet të shoqërohet me akt-ekspertizën e kryer nga eksperti kontabel.

Kjo kërkesë për kualifikim, konsiderohet e përmbushur nëse në 2 (dy) bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Shënim: Akt Ekspertizë e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, duhet të paraqitet nga OE vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, gërma "c" të Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar", i ndryshuar, ku parashikohet se: "Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabël ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, **për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej treguesve të mëposhtëm:** i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh; ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionëlekësh; iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël"

Argumentimi:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr.10091 date 5.3.2009 “Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit te ekspertit kontabel te regjistruar dhe te kontabilistit te miratuar” i ndryshuar.

2.2.3 Një dokument lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore që vërteton se subjekti i ka plotësuar detyrimet e taksave dhe tarifave vendore për vitin 2022 dhe për keestet e maturuara të vitit 2023, referuar ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar si dhe Vendimit të Këshillit Bashkiak përkatës ku subjekti ushtron aktivitetin për të gjitha vendet ku ushtron aktivitet sipas ekstratit të QKR. Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilën është regjistruar sipas QKB.

(Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetedeklarimit sipas shtojcës 8 në DST, dokumentet përkatëse vërtetuese do të paraqiten nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar sipas Nenit 77 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”; Kreut V, Seksioni III, Nenin 43, pika 6 të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” si dhe sipas Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” (i ndryshuar). Duke qenë se Autoriteti Kontraktor, Bashkia Gramsh, është njësi e vetëqeverisjes vendore, e cila funksionon dhe ka kompetenca të përcaktuara sipas Ligjit Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Njësia e Prokurimit argumenton se pika 2.2.3 është vendosur në kuadër të Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e Taksave Vendore” (i ndryshuar), Neni 5, gërma “c” ku citohet se: “...përcakton numrin e kësteve të pagimit të taksës dhe afatet e kryerjes së tyre, si dhe kushtet lehtësuese në rastet e pagesës së plotë dhe përpara afateve të detyrimeve fiskale”.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1 Përvojë të suksesshme në realizimin e të paktën:

a. punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 2 250 000 (dy milion e dyqind e pesëdhjetë mijë) lekë (30% e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet (pa TVSH) dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

ose

b. Punë të ngjashme deri në një kufi ku vlera monetare totale e punëve të kryera e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit është në një vlerë jo më e vogël se 7 500 000 (shtatë milion e pesëqind) lekë (vlerës limit të kontratës që prokurohet)

Plotesimi i njërës prej kushteve të siperpërmendura e ben oferten te kualifikueshme.

Vlerësimi i përvojes së suksesshme të Operatorit/ve Ekonomik do të kryhet bazuar në dokumentat e mëposhtme:

i) Për kontrata të realizuara me ente publike, operatori/et ekonomik, duhet të paraqes/in dokumentacionin e mëposhtem, ku të shenohen vlera, afati i perfundimit të kontrates dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve:

1. Formular vlerësimi për realizimin e punimeve, shoqëruar me:
2. Kontraten/at e Sipermarrjes;
3. Situacionin perfundimtar të objektit;
4. Aktin e kolaudimit;

5. Çertifikaten e marrjes ne dorezim;
6. Faturat tatimore te prera per objektin;

Formulari i vleresimit duhet te percaktoje saktesisht cilesine e kryerjes se puneve, faktin nese kontrata eshte realizuar me sukses, perqindjen e punimeve ne rast bashkimi te shoqerive, etj.

ii) Per kontrata te realizuara me sektorin privat, operatori/et ekonomik duhet te paraqes/in dokumentacionin e meposhtem:

1. Formular vleresimi per realizimin e punimeve, shoqeruar me:
 2. Kontraten/at e Siper marrjes;
 3. Situacionin perfundimtar te objektit;
 4. Aktin e kolaudimit; (*në rastet kur ky dokumentacion lëshohet*)
 5. Fatura tatimore perfundimtare.
- Kontraten e bashkimit te operatoreve dhe prokuren e posacme te deklaruar ne fazen e tenderimit;
 - Per kontratat e realizuara si Nenkontraktor, operatori ekonomik ofertues duhet te paraqesë:
 - a) Kontratë baze ndermjet Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor; si dhe
 - b) Miratimin zyrtar si nenkontraktor nga ana e Autoritetit Kontraktor.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura për përvojen e suksesshme e bën ofertën të kualifikueshme.

Pika 2.3.1 germa “a” plotesohet nga anetari i cili ka perqindjen me te madhe te pjesemarrjes ne bashkim. Anetaret e tjere te bashkimit do te paraqesin kontratat e ngjashme ne raport me perqindjen e pjesemarrjes se tyre ne bashkim. Ne rastin kur operoret ekonomike, anetare te nje bashkimi, kane te njejten perqindje pjesemarrjeje ne bashkim, vendosin me marreveshje ne kontraten e bashkepunimit se cila prej tyre do te permbushe kete kusht.

Kurse pika 2.3.1 germa “b” duhet te plotesohet nga te gjithë anetaret e bashkimit ne raport me perqindjen e pjesemarrjes se tyre ne bashkim. (Neni 88, pika 3, i VKM-se nr.285 date 19.05.2021 “Per miratimin e rregullave te prokurimit publik”).

Argumentimi:

Përvoja e sukseshme si dhe vlerësimi i saj u hartua duke iu referuar Nenit 77, pika 4 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe bazuar ne Nenin 55, pika 4, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që Operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që:

a. punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 2 250 000 (dy milion e dyqind e pesëdhjetë mijë) lekë (30% e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet (*pa TVSH*) dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

ose

b. Punë të ngjashme deri ne nje kufi ku vlera monetare totale e punëve të kryera e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit është në një vlerë jo më e vogël se 7 500 000 (shtatë milion e pesëqind)lekë (vlerës limit të kontratës që prokurohet)

Plotesimi i kushteve te siperpermendura e ben oferten te kualifikueshme.

Gërma (a) plotësohet nga anëtari i cili ka për qindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me për qindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse gërma (b) duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e

bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Gjithashtu referuar VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, Kreu XI, Neni 88, pika 3 citohet se: *”Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, kushti i përcaktuar në shkronjën “a”, të pikës 5, të nenit 39, të këtyre rregullave, plotësohet nga anëtari, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontrata të ngjashme, në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cila prej tyre do të përmbushë këtë kusht.”*

Autoriteti Kontraktor argumenton se Puna e ngjashme është kërkesë, e cila shërben për të vlerësuar përvojën e duhur të Ofertuesve. Vlerësimi i përvojës realizohet duke paraqitur dokumentat e kërkuara sipas pikava, të cilat vërtetojnë eksperiencën në realizimin e punëve publike të ngjashme, si dhe janë një garanci më shumë për Autoritetin Kontraktor me qëllim përmbushjen me sukses të kontratës objekt prokurimi.

Përvoja e sukseshme si dhe vlerësimi i saj është hartuar duke iu referuar Nenit 77, pika 4 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” ku qartazi përcaktohet se: *”Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.*

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”, si dhe bazuar ne Nenin 55, pika 4, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, ku përcaktohet se: *Lidhur me kërkesat për përvojën e ngjashme, vlera e kërkuar në procedurat e thjeshtuara duhet të jetë:*

a) Për kontratat e punëve:

i.. punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 30 % e vlerës së përllogaritur të kontratës ose lotit13që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

ii. punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e madhe se vlera limit e kontratës ose lotit që prokurohet.

Plotësimi i njërës prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

2.3.2 Liçensa profesionale lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës.

Operatori ekonomik ofertues, duhet të deshmojë se disponon liçensë profesionale për zbatim punimesh në ndërtim, duke përfshirë kategoritë e nevojshme për zbatimin e kontratës. Për këtë duhet të paraqesin liçensën perkatese të shoqërisë, bazuar në formatin e miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr.42 datë 16.01.2008 “Per miratimin e rregullores për kriteret dhe Procedurat e dhenies së liçensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të Subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, i ndryshuar.

• Per punimet e pergjithshme te ndertimit kompania duhet te kete liçensat e meposhtme:

- *N.P-1 (Punime germimi e toke)* Niveli A
- *N.P-4(Rrugë,autostrada,mbikalime,hekurudha,tramvai,metro,pista eroportuale* Niveli A
- *N.P-12 (Punime të inxhinierisë së mjedisit)* Niveli A

• Per punimet speciale te ndertimit duhet te kete liçensat e meposhtme:

- *N.S.-1 (Punime për prishjen e ndërtimeve)* Niveli A
- *N.S.-18 (Punime topogjeodezike,)* Niveli A
sipas modelit të leshuar nga MPPT;

Operatorët ekonomike duhet të kenë licencat e nevojshme për zbatimin e kontratës. Për këto ata duhet të paraqesin licencën përkatëse të shoqërisë, bazuar në formatin e miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 42 datë 16.01.2008 "Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat për dhenien e licencave profesionale për zbatimin, klasifikimin dhe disiplinimin e personave juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimore".

Operatorët e huaj duhet të barazvlerësojnë (ekuivalentojnë) licencat profesionale që ata kanë lëshuar nga vendi i origjines, në Ministrinë e Infrastruktura dhe Energji, (ose Ministrinë kompetente) në Republikën e Shqipërisë. (Rregullore për kriteret dhe procedurat për lëshimin e licencave profesionale për zbatimin, klasifikimin dhe disiplinimin e personave juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi, miratuar nga VKM, Nr. 42, datë 16.01.2008). **Mosparaqitja në këto forme është kusht skualifikues.**

Kategoria e kërkuar	Pershkrimi i kategorisë sipas legjislacionit të fushës	Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse	Niveli i klasifikimit i kërkuar për kategorinë respektive
N.P 1 - A	(Punime gjërmimi në tokë)	Në Preventivin e punimeve për procedurën objekt prokurimi ka zëra pune që lidhen me gjërmime në tokë (Kap.2 i preventivit)	0-20
N.P 4 - A	(Rrugë,autostrada, Mbikalime,hekurudha Tramvai,metro Pista autoportuale)	Në Preventivin e Punimeve ka zëra pune që lidhen me shtresa rrugësh (Kap.2 i preventivit, shtresa asfaltike,skarifikime shtresash asfalti,shtrese binderi,asfaltobetoni etj)	0-20
N.P 12 - A	(Punime të inxhinierisë së mjedisit,)	Në Preventivin e punimeve për procedurën objekt prokurimi ka zëra pune gjelberimi,ndërtime pusëtash etj.	0-20
N.S 1 - A	(Punime për prishjen e ndërtimeve)	Në Preventivin e Punimeve ka zëra pune që lidhen me prishje muresh betoni dhe mure guri,tulle etj (Kap 1 i preventivit)	0-20
N.S 18- A	(Punime topogjeodezike,)	Në Preventivin e Punimeve ka zëra pune që lidhen me matje topografike (punime kanalizime ujera shiu Kap.4 i preventivit)	0-20

Operatorët e huaj duhet të barazvlerësojnë (ekuivalentojnë) licencat profesionale që ata kanë lëshuar

nga vendi i origjinës, në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, (ose Ministrinë kompetente) në Republikën e Shqipërisë. (Rregullore për kriteret dhe procedurat për lëshimin e licencave profesionale për zbatimin, klasifikimin dhe disiplinimin e personave juridikë që ushtrojnë veprimtari ndërtimi, miratuar nga VKM, Nr. 42, datë 16.01.2008).

Argumentimi:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në Nenin 77, pika 1 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”; Kreut V, Seksioni III, Neni 39, pika 6/a, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe mbështetur në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”. Referuar kategorive të kërkuara, autoriteti kontraktor argumenton teknikisht se kjo kërkesë është vendosur sipas zërave të preventivit të punimeve.

Për sa më lart, me qëllim realizimin e punës objekt prokurimi, është kërkuar që Ofertuesit të jenë të pajisur me Licencë profesionale për kategoritë, të cilat janë vendosur sipas volumeve të punimeve dhe vlerave që përmban Preventivi për cdo zë pune mbështetur në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 42, datë 16.1.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, ku janë përcaktuar kategoritë dhe nënkategoritë përkatëse. Kjo kërkesë është vendosur nga Autoriteti Kontraktor me qëllim shqyrtimin e kualifikimit profesional të Ofertuesve në kuadër të veprimtarisë tregtare objekt prokurimi.

2.3.3 Stafi kryesor e mbështetës, punonjësit, çertifikimet, i kualifikuar për keto punime.

Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij si drejtues teknik të shoqërisë, inxhinierët e mëposhtëm:

- Inxhinier Ndërtimi 1(nje)
 - Inxhinier Mjedisi 1(nje)
 - Inxhinier Topograf 1(nje)
 - Inxhinier Elektrik 1 (një)
- Inxhinierët e sipërcituar duhet të figurojnë si drejtues teknik në licencën e operatorit ekonomik ofertues dhe në listëpagesat e shoqërisë për për te pakten 3 (tre) muajt e fundit korrik 2023-shtator 2023 . Për inxhinierët duhet të paraqiten:Diploma, Kontratë individuale pune (*e vlefshme*)

Ky kriter konsiderohet i përmbushur me paraqitjen e formularit të vetdeklarimit sipas shtojces 8

Shënim:Autoriteti Kontraktor do të beje verifikimin e dokumentacionit në përputhje me vetedeklarimin e bere gjate fazes se ofertimit. Konstatimi i mosperputhjeve midis Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit dhe dokumentacionit të dorëzuar përben kusht s’kualifikimi. Operatori ekonomik i kualifikuar i pari duhet të paraqesi dokumentacionin provues, original ose të noterizuar sipas deklaratës së mësipërme përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, brenda afatit nga dërgimi i njoftimi për paraqitjen e tyre.

Argumentimi:

Autoriteti Kontraktor argumenton se kërkesa për stafin inxhinierik është vendosur sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “c”.

Kriteri për stafin drejtues teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontrates, relacionin teknik dhe

zërat e punimeve. Nevoja për inxhinierët në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit. Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast rezulton në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët të objekteve. Numri i stafit kryesor teknik si numri i inxhinierëve të sipercituar, etj është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën. Drejtuesi i teknik është përgjegjës për ndërtimin në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë brenda kushteve të kontratës. Bazuar në parashikimet e mësipërme të legjislacionit për prokurimin publik, Autoriteti Kontraktor ka kërkuar që operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij drejtues teknik të cilët kanë një rol të rëndësishëm në mbarëvajtjen e punimeve pasi ata janë përgjegjës për zbatimin e objektit sipas projektit dhe në përputhje me kushtet teknike të zbatimit të tij.

Kërkesa specifike për Inxhinierët e kërkuar është përcaktuar në kuadër të analizës teknike që i është bërë Preventivit të Punimeve (nga ku përcaktohet qartazi dhe profili inxhinierik) si dhe në bashkërendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë sipas pikës 2.3.2, kapaciteti teknik në DST. Duke marrë në konsideratë Projektin e zbatimit si dhe Preventivin e Punimeve rezulton se është e domosdoshme që çdo Ofertues të ketë pjesë të stafit Inxhinierë të kërkuar sipas pikës 2.3.4, të cilët në bashkëpunim me njëri tjetrin, stafin mbështetës si dhe me fuqinë punëtore të shoqërisë do të realizojnë me sukses kontratën objekt prokurimi.

2.3.4 Staf i Ndihmes/Mbështetës/Certifikimet ose Kualifikimet mbështetëse:

a) Operatori ekonomik, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë edhe stafin mbështetës (jo domosdoshmërisht drejtues teknik në licencën e shoqërisë), si më poshtë:

- 1 (një) Arkitekt

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin:

Për secilin pjesëtar të stafit teknik të mesipërme duhet të paraqesin, Kontrate pune e vlefshme, diplome , si dhe të figurojnë në Listpagesat e Shoqërisë për Periudhën korrik 2023-shtator 2023.

Ky kriter konsiderohet i përmbushur me paraqitjen e formularit të vetdeklarimit sipas shtojces 8.

Shënim:Autoriteti Kontraktor do të beje verifikimin e dokumentacionit në përputhje me vetedeklarimin e bërë gjatë fazës së ofertimit. Konstatimi i mospërputhjeve midis Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit dhe dokumentacionit të dorëzuar përben kusht s'kualifikimi. Operatori ekonomik i kualifikuar i pari duhet të paraqesin dokumentacionin provues, original ose të noterizuar sipas deklaratës së mësipërme përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, brenda afatit nga dërgimi i njoftimit për paraqitjen e tyre.

b) Operatorët ekonomik të kenë në stafin e tyre **1 (një)** punonjës të pajisur me certifikatë “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë”, në përputhje me klauzolat e ligjit Nr. 10327, datë 18.02.2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe V.K.M-së Nr. 312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores për sigurinë në kantier”. Për këtë duhet të paraqitet certifikata e trajnimit për “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit për punë”, e dhënë nga një organizem i licënsuar, shqiptar ose i huaj, si edhe të figurojë në listpagesën e shoqërisë për periudhën korrik 2023-shtator 2023 (ose ekuivalente)

c) Operatorët ekonomik të kenë në stafin e tyre **1 (një)** punonjës të pajisur me certifikatë “Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave”, e cila të jetë e lëshuar nga

shoqëritë e akredituara ose nga organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë. Për këtë duhet të paraqitet çertifikata e trajnimit, e dhënë nga një organizem i licencuar, shqiptar ose i huaj, si edhe të figurojë në listpagesën e shoqërisë për periudhën korrik 2023-shtator 2023.

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesë:

- a) Kontrate pune;
- b) diplome/certificate

c) Operatorët ekonomik të kenë në stafin e tyre 1 (një) Inxhinier pjese e stafit të shoqërisë të jete i pajisur me çertifikate “Ekspert Zjarrefikes”, leshuar nga MZSH si edhe të figurojë në listpagesën e shoqërisë për periudhën korrik 2023-shtator 2023

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesë:

- a) Kontrate pune;
- b) diplome/çertifikate

d) Operatori ekonomik për të siguruar shërbimin mjekësor në shoqëri duhet të ketë të punësuar **një mjek** të përgjithshëm ose të ketë të kontraktuar nga jashtë këtë shërbim. Në rastin kur mjeku është i punësuar në shoqëri, duhet të paraqesë një kontratë pune të vlefshme, licensë për ushtrimin individual të profesionit, diplomë dhe urdher mjeku.

Në rastin kur mjeku është kontraktuar nga jashtë, do të paraqitet kontrata për këtë shërbim, licensa përkatëse, si dhe faturen e këtij shërbimi, bazuar në VKM Nr. 108, datë: 09.02.2011 “Për aftësitë që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në pune” (ndryshuar me VKM nr. 632, datë 15.7.2015).

Në rast se mjeku është i punësuar në shoqëri, duhet të figurojë në listëpagesat e shoqërisë për periudhën korrik 2023-shtator 2023.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës Nr. 8, të DST-ve dhe në zbatim të V.K.M – së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, neni 26 “Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit”, pika 6 “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/entikontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”, si më sipërkërkuar

Argumentimi:

Per te provuar kapacitetet teknike dhe profesionale te shoqërisë është kërkuar deshmimi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për realizimin e kontratës në mbështetje të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “c”.

Sqarime se, numri i punonjësve është përcaktuar referuar volumeve të punës që do të kryhen, afatit të realizimit të kontratës objekt prokurimi si dhe grafikut të punimeve të përcaktuara nga autoriteti kontraktor me qëllim realizimin me sukses dhe në kohë të kontratës.

Per te provuar kapacitetet teknike dhe profesionale te shoqërisë është kërkuar personeli i nevojshëm inxhinierik referuar zerave të preventivit të objektit për realizimin e kontratës në Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6. Bazuar në parashikimet e mësipërme të legjislacionit për prokurimin publik, Autoriteti Kontraktor ka kërkuar që operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij inxhinierë të cilët kanë një rol të rëndësishëm në mbarëvajtjen e punimeve pasi ata janë përgjegjës për zbatimin e objektit sipas projektit dhe në përputhje me kushtet teknike të zbatimit të tij. Dokumentacioni plotësues i kërkuar në kriteret e vecanta për kualifikim pjesë përbërëse e dokumentave të tenderit, sikundër janë, kontratë

pune e vlefshme, Cv apo qënësia e tyre në listpagesat e shoqërisë, janë vendosur për arsye se me paraqitjen e këtij dokumentacioni vërtetohet se këta punonjes *janë operativë* pranë Ofertuesve të mundshëm dhe në këtë mënyrë Autoriteti Kontraktor krijon bindjen se Operatorët ekonomikë pjesëmarrës zotërojnë personelin e nevojshëm për realizimin me sukses të objektit që prokurohet.

Gjithashtu ne reference te frymes se ligjit per prokurimin publik dhe konkretisht te nenit 77/4, i cili percakton se ofertuesit dhe rrjedhimisht fituesi i mundshem, vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën eshte kerkuar nje mjek bazuar ne:

Në VKM nr. 742, datë 6.11.2003 “Përdisa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.692, datë 13.12.2001 të këshillit të ministrave "për masat e veçanta të sigurimit dhe të mbrojtjes së shëndetit në punë" është përcaktuar: "2/1. **Punëdhënësi siguron funksionimin e shërbimit mjekësor, nëpërmjet mjekut të ndërmarrjes, në të gjitha subjektet që ushtrojnë veprimtari prodhuese, private ose shtetërore, vendase ose të huaja, juridike ose fizike.** 2/2. Mjekët e ndërmarrjes pajisen me licencë profesionale nga Ministria e Shëndetësisë, në përputhje me vendimin nr.500, datë 23.11.1992 të Këshillit të Ministrave "Për dhënien e licencave për ushtrimin e profesionit në fushën e mjekësisë, në profesion të lirë privat", i ndryshuar. 2/3. **Mjekët e ndërmarrjes merren në punë si nëpunës të ndërmarrjes dhe varen drejtpërdrejt nga punëdhënësi.** Punëdhënësi e njej mjekun me detyrat e shërbimit shëndetësor të ndërmarrjes dhe kërkon zbatimin e tyre, sipas legjislacionit të punës. Marrëdhëniet ndërmjet punëdhënësit dhe mjekut të ndërmarrjes përcaktohen në bazë të kontratës së punës që lidhin palët, në përputhje me legjislacionin në fuqi. [...] "12/1. Marrja në punë e mjekut është e detyrueshme për të gjitha subjektet, veprimtaria e të cilave klasifikohet sipas vendimeve nr.459, datë 22.7.1998 "Për substancat e rrezikshme", nr.419, datë 4.8.2000 "Për objektet e rrezikshme" dhe nr.207, datë 9.5.2002 "Për përcaktimin e punëve të vështira ose të rrezikshme" të Këshillit të Ministrave, pavarësisht nga numri i të punësuarve. 12/2. **Për subjektet që nuk përfshihen në pikën 12/1 të këtij vendimi, marrja në punë e mjekut të ndërmarrjes është e detyrueshme për ato ndërmarrje, ku numri i të punësuarve është jo më pak se 15 punonjës.** 12/3. Mjeku i ndërmarrjes mban përgjegjësi sipas ligjit për pasojat, që mund të vijnë nga moszbatimi i detyrave të përcaktuara sipas pikës 2/4 të këtij vendimi[...]" III.1.5. **Referuar kriterit të përcaktuar nga autoriteti kontraktor për disponimin nga ana e operatorëve ekonomikë të një mjeku në stafin e tyre teknik eshte plotesisht I mbeshetur ne aktet ligjore dhe siguron kontrollin shëndetësor në punë të punëmarrësve.**

2.3.5 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar si staf teknik punonjesit specialistë të kualifikuar ne profilet perkatese si më poshtë:

- | | |
|---------------------------|----------|
| - Teknik Ndertimi | 1 (nje) |
| - Teknik Topograf/gjeodet | 1 (nje) |
| - Teknik Hidroteknik | 1 (nje) |
| - Elektracist | 2 (dy) |
| - Hidraulik | 2 (dy) |
| - Karpentiere | 2 (dy) |
| - Hekurkthyes | 2 (dy) |
| - Murator | 1 (nje) |
| - Saldator | 1 (nje) |
| - Manovrator | 1 (nje) |

Per punojesit e mesiperem duhet te paraqiten:

- Kontratat e punës individuale (të vlefshme).
- Diploma për formimin profesional (të vlefshme), të cilat duhet të jenë të lëshuara nga institucione publike/private të licensuara sipas ligjit Nr. 15/2017 “Për arsimin dhe

formimin profesional në R.Sh.”, i ndryshuar, si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë për periudhën korrik 2023-shtator 2023”, sipas Ligjit Nr. 8734, datë 01.02.2001 dhe Ligji Nr. 13/2013.

- Për teknikun e ndërtimit dhe teknikun topograf të paraqiten edhe diplomat e shkollës së mesme profesionale ose licencat përkatëse.

Per profesionetsi me sipër, operatori ekonomik duhet te plotesoje tabelën si me poshtë:

Nr.	Emer Mbiemer i punonjesit	Profesioni	Institucionipublik/privat leshues i certifikates/diplomes	Nr NIPT (Ne rast se leshuesi eshte institucion privat)
1				
2				
3..				

Për manovratorët të paraqitet kontrata e punës dhe dëshmia e aftësisë profesionale lëshuar nga DPSHTRR .Per manovratorin te paraqitet kontrata e punes e vlefshme dhe deshmia e aftesise profesionale leshuar nga DPSHTRR.(Ne rastin kur punonjesit e mesiperm jane jane te kontraktuar me kontrate pune respektivisht per mjetet e marra me qira , nuk kerkohet te figurojne ne listpagesat e shoqërisë.

Operatori ekonomik fitues duhet te dorezoje prane AK, perpara lidhjes se kontrates, te gjithe dokumentacionin provues per vetedeklarimet ne formularin permbledhes te vetedeklarimit.

Argumentimi:

- Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht:
- Vendosja e ketij kriteri per fuqine punetore eshte bere ne perputhje me zerat dhe volumet e preventivit, me afatin e zbatimit te punimeve sipas grafikut te punimeve, qe eshte perllogaritur ne nje kohe te shkurter i cili kerkon fuqi punetore te shtuar dhe me mjetet e kerkuara per zbatimin me sukses te kesaj kontrate.

2.3.6 Operatori Ekonomik duhet te kete fuqi minimale punetore te nevojshem per ekzekutimin e objektit te prokurimit, me nje numer prej mesatarisht **33 (tridhjetë e tre)**personave, per periudhën korrik 2023-shtator 2023.

Eshtë e mjaftueshme paraqitja e deklarates, sipas shtojcës nr.8. Ndersa operatori ekonomik fitues, para lidhjes se kontrates, duhet te dorezoje dokumentacionin si më poshtë:

- Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet Shoqërore ose Administrata Tatimore sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi, ku të specifikohet numri i punonjësve për 3 muajt e fundit, nga data e zhvillimit të tenderit.
- Listë pagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për për 3 muajt e fundit, nga data e zhvillimit të tenderit.

Shënim: Autoriteti Kontraktor do te beje verifikimin e dokumentacionit ne perputhje me

vetedeklarimin e bere gjate fazes se ofertimit. Konstatimi i mosperputhjeve midis Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit dhe dokumentacionit te dorezuar perben kusht s'kualifikimi. Operatori ekonomik i kualifikuar i pari duhet të paraqesi dokumentacionin provues, original ose te noterizuar sipas deklaratës së mësipërme përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, brenda afatit nga dërgimi i njoftimit për paraqitjen e tyre.

Argumentimi:

Kjo kërkesë mbështetet në Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “ç”.

Qëllimi i vendosjes së këtij kushti është i implementuar sipas dispozitave ligjore dhe shërben si një garanci që kontrata objekt prokurimi do të realizohet me sukses sipas Specifikimeve Teknike (të cilat do publikohen së bashku me Dokumentat e Tenderit) si dhe punimet do të kryhen brenda afatit kohor të parashikuar në Njoftimin e Kontratës.

Nga ana teknike argumentojmë se numri mesatar i punonjësve, prej gjithsej 23 punonjësish, është caktuar në bazë të llogaritjeve të zërave të punës dhe volumit përkatës të cdo zëri në preventiv si dhe grafikut në zbatimit të punimeve, të cilat duhet të përfundojnë Brenda nje periudhe te shkurter nga data e nënshkrimit të kontratës, mbështetur kjo në VKM Nr. 629 datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizat teknike të tyre”. Nëpërmjet këtij kushti kërkohet që të vërtetohet se Ofertuesit zotërojnë kapacitetet e nevojshme teknike lidhur me stafin që kanë në dispozicion, si dhe shërbejnë për të t'i dhene garancitë e nevojshme Autoritetit Kontraktor mbi përmbushjen me sukses të kontratës objekt prokurimi. Numri i punëtorëve si dhe personeli i nevojshëm për zbatimin e kontratës është përcaktuar duke marrë në konsideratë vlerën e kontratës që prokurohet, si dhe kohëzgjatjen e saj.

Gjithashtu për të vërtetuar zotërimin e fuqisë punëtore si dhe stabilitetin e saj eshte kërkuar edhe vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore si dhe listpagesat e punonjësve mbështetur edhe në Kreun V, Seksioni III, Neni 39, pika 8 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” sipas së cilës: *”Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”.*

2.3.7 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

Nr	Lloji i Makinerive	Statusi	Sasia
1	Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës mbi 20 ton	në pronësi ose me qira	Copë 2
2	Kamioncine vetëshkarkues me kapacitet mbajtës mbi 10 ton	në pronësi ose me qira	Copë 1
3	Kamioncine me kapacitet mbajtës mbi 3.5-ton	në pronësi ose me qira	Copë 2
4	Kamioncineme kapacitet mbajtës max 2 ton	në pronësi ose me qira	Copë 2
5	Kamion me vinc	në pronësi ose me qira	Copë 1
6	Fadrome me Goma	në pronësi ose me qira	Copë 1
7	Eskavator me goma	në pronësi ose me qira	Copë 1
8	Autobot uji	në pronësi ose me qira	Copë 1
9	Autobeniere	në pronësi ose me qira	Copë 1
10	Mini fadrome	në pronësi ose me qira	Cope 1
11	Elektrosaldatrice	në pronësi ose me qira	Copë 1
12	Matrapik	në pronësi ose me qira	Copë 1
13	Vibrator betoni	në pronësi ose me qira	Copë 2
14	Pompa Suvatimi	në pronësi ose me qira	Copë 1

15	Skeleri	në pronësi ose me qira	Min 100 m2
16	Autopompe betoni	në pronësi ose me qira	Copë 1
17	Tranxhe per prerjen e kthimin e hekurit	në pronësi ose me qira	Copë 1
18	Depozite uji 5000l	në pronësi ose me qira	Cope 2
19	Pompa Uji	në pronësi ose me qira	Copë 1
20	Rul vibrues minimumi 5 ton	në pronësi ose me qira	Copë 1
21	Pajisje niveluese per nivelim shtresash	në pronësi ose me qira	Copë 1
22	Gjenerator	në pronësi ose me qira	Copë 1
23	Greider	në pronësi ose me qira	Copë 1

Te paraqiten mjete dhe pajisje te mbrojtjes ne pune te punetoreve, personelit si me poshte:

- Kokore minimumi 33cope
- Uniforma/Jelek pune 33 cope
- Për mjetet që shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet dokumentacioni që verteton pronësinë e mjetit: - certifikatën e pronësisë; - leja e qarkullimit; - certifikatën e kontrollit teknik; siguracionin; certifikatë transporti, fotot përkatëse ku të duket qarte targa;
- Ndërsa për mjete të marra me qira krahas dokumentacionit të mesiperm, duhet të paraqitet edhe kontrata notoriale e qirase, e cila duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën deri në përfundimin e plotë të punimeve.
- Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet kontrata e blerjes ose fatura e zhdoganimit ose fatura tatimore përkatëse, fotot ku të duket qarte dhe shërbimi i tij, ndërsa për mjete të marra me qira krahas dokumentacionit të mesiperm, duhet të paraqitet edhe kontrata notoriale e qirase, e cila duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën deri në përfundimin e plotë të punimeve

Ky kriter konsiderohet i përmbushur me paraqitjen e formularit të vetdeklarimit sipas shtojcës 8

Argumentimi: Kërkesa e mesipërme është vendosur sipas pikës 4, të Nenit të 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe Kreut V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, germa ”d” të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Nepermjet ketyre kërkesave, Operatorët ekonomikë duhet të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që kanë në dispozicion apo që mund t’u vihen në dispozicion me qëllim përmbushjen me sukses të kontratës objekt prokurimi.

Për të përcaktuar llojin dhe numrin e mjeteve/makinerve të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, sipas zerave të preventivit dhe specifikimeve teknike të hartuara nga specialistet e fushës. Çdo mjet i kërkuar përkon me proceset ndërtimore sipas zerave përkatës të Preventivit. Numri i makinerve është përcaktuar duke marrë në konsideratë volumet e punimeve për secilin zë pune mbështetur kjo në VKM Nr. 629 datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizat teknike të tyre”(Ndryshuar me VKM nr. 631, datë 26.10.2018).

2.3.8 Operatori/et ekonomik duhet të paraqesin certifikatat e cilësisë së punimeve, për objektin që prokurohet, të cilat duhet të jenë të perkthyer në gjuhën shqipe dhe të noterizuara, sipas standardeve:

- Çertifikatat e cilësisë sipas Standartit **ISO 9001:2015 (për sistemin e menaxhimit të cilësisë)**, ose certifikatën ekuivalente, të vlefshme,

- Çertifikatat e cilesise sipas Standartit **ISO 14001:2015 (per sistemin e menaxhimit te mjedisit)**, ose certifikaten ekuivalente, e vlefshme
- Çertifikatat e cilesise sipas Standartit **ISO 45001-2018 (per sistemin e menaxhimit te shendetit dhe sigurise ne pune)**, ose certifikaten ekuivalente, e vlefshme,

Ne rastin e bashkimit te perkohshem te shoqerive secili operator duhet te paraqese certifikatat e mesiperme, ne varesi te punimeve qe do te marri persiper konform marreveshjes. Të gjitha certifikatat e mësipërme duhet të jenë të vlefshme të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Argumentimi:

Kriter i vendosur ne reference te nenit 79 te ligjit per prokurimin publik i cili percakton se mund te kerkohen certifikata te tilla, te cilat ne rastin konkret vleresohen te nevojshme persa i perket cilesise dhe sigurise ne pune. Pra konsiderohet si kriter i lidhur ngushtesisht me objektin e kontrates qe prokurohet dhe i bazuar ne LPP. Kërkesat e cilësisë të përcaktuara sipas pikës 2.3.9 janë vendosur në mbështetje të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 79, pika 1 ku citohet se: “*Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë*”, si dhe ne zbatim te Neni 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ku përcaktohet se: “*Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit*”.

- 2.3.9** Operatori ekonomik te disponojë ose te kete me kontrate sherbimi license lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licensimit për grumbullim dhe transportim të Inerteve Kodi III.2.B shoqeruar me aktin e miratimit.

Shoqëritë e huaja duhet te kene kryer ekuivalentimin (njehsimin) e licensave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Transportit dhe Infrastruktures, Republika e Shqipërisë, sic percaktohet ne *Rregulloren për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale te zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit te subjekteve juridike qe ushtrojne veprimtari ndertimi, e miratuar me VKM Nr.42, date 16.01.2008.*

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike janë hartuar nga inxhinierë me licensë, bashkëngjitur DST ne SPE.

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për punimet objekt prokurimi, të cilat duhet të shprehin qartë kërkesat e autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe të materialeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 39, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar**, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.*